



BASHKIA VLORË – DREJTORIA E URBANISTIKËS


RIKONSTRUKSION I RRUGËS “SHTJEFEN GJECOVI” DHE “HAXHI XHYHERI”.

RELACION PËRSHKRIMI

RELACION PËRSHKRIMI

1. Rruga “Shtjefen Gjecovi” dhe “Haxhi Xhyheri”.

Rruga “Shtjefen Gjecovi” dhe “Haxhi Xhyheri” ndodhen në rajonin 5 të qytetit, fillojnë nga rruga Transballkanike duke vazhduar në jug. Rrugët janë të gjata rreth 810m dhe janë rrugë të rëndësishme lidhëse të kësaj zone me pjesën tjetër të qytetit.



Për realizimin e këtij projekti janë kryer studime në terren të gjendjes faktike të rrugës në të gjithë gjatësinë e saj. Mungesa e investimeve në këtë segment ka çuar në një gjendje ku nevojiten ndërhyrje të menjëhershme. Këto ndërhyrje duhet të jenë në të gjithë sipërfaqen e segmentit rrugor. Ndërhyrja e përgjithshme do të konsistojë në të gjithë gjatësinë e rrugës si dhe rindërtimi i pjesëshëm i kanaleve kulluese anësore.

Gjendja ekzistuese e trupit të rrugës



Shtresat që do të përdorën në të gjithë rrjetin rrugor janë si më poshtë

- shtresë stabilizanti 10 cm
- shtresë binderi 4 cm
- shtresë asfalto betoni 4 cm.

Projekti parashikon riasfaltimin e plotë të rrugës dhe riparimi i dëmeve të lokalizuara.

Rruga ekzistuese perpara fillimit të punimeve do të rafshohet me eskavator dhe mbasi të realizohet një profil i një trajtshëm do të shtrohet mbi rrugë një tapet stabilizanti 10 cm në të gjithë gjatësinë e rrugës.

Mbi tapetin e stabilizantit do të plotësohet më tej shtresa e binderit 4cm dhe e asfaltobetonit 4 cm. Mbas përfundimit të shtresave puna do të vijojë më tej më vijëzimin gjatësor të rrugës. Rruga ka gjatësinë rreth 810 m.

PUNOI: Ark. Erisa Muka
Ark.Orges Deraj
Urb.Evangjelica Rapaj
Ing.Darjan Hudhra

